



NJOFTIM PËR MEDIA

Ditën e hënë, në datën 11 dhjetor 2017, u zhvillua mbledhja e radhës së Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

Gentian	SALA	Kryetar
Sami	NEZAJ	Zëvendëskryetar
Agron	GJEKMARKAJ	Anëtar
Gledis	GJIPALI	Anëtar
Piro	MISHA	Anëtar
Suela	MUSTA	Anëtar
Zylyftar	BREGU	Anëtar

AMA, pasi mori në shqyrtim çështjet e rendit të ditës, vendosi:

1. “Miratimin e Kodit të Transmetimit për median audiovizive”. (**Vendimi nr. 228, datë 11.12.2017**);
2. “Miratimin e projektbuxhetit të Autoritetit të Mediave Audiovizive për vitin 2018” (**Vendimi nr. 229, datë 11.12.2017**);
3. “Rinovimin e autorizimit të shoqërisë “KL-ED Kabëll” sh.p.k., për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv Kabllor KL-ED”. (**Vendimi nr. 230, datë 11.12.2017**);
4. “Konstatimin e pavlefshmërisë së autorizimit të shoqërisë “Ultranet” sh.p.k., (ndryshuar ALB_TRA_NET SCU sh.p.k.), autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në internet OTT”. (**Vendimi nr. 231, datë 11.12.2017**);
5. “Pranimin e kërkesës së subjektit person fizik Fitim Goga, autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv kabllor Erden”, duke kalua të drejtat e autorizimit tek subjekti, person fizik Krenar Goga” (**Vendimi nr. 232, datë 11.12.2017**);
6. “Refuzimin e ankimit administrativ dhe lënien në fuqi të sanksionit gjobë, nr. 88, datë 10.10.2017, në masën 1,000,000 lekë, të vendosur nga Grupi i Inspektimit, ndaj shoqërisë “RTV Adriamed” sh.p.k., autorizuar për subjektin audioviziv privat vendor “TV AdriaMed”. (**Vendimi nr. 233, datë 11.12.2017**);
7. “Pranimin e ankimit administrativ dhe shfuqizimin e sanksionit gjobë, nr. 89, datë 27.10.2017, në masën 1,000,000 lekë, të vendosur nga Grupi i Inspektimit, ndaj shoqërisë “Ora” sh.a., autorizuar për subjektin audioviziv privat vendor “Ora News”. (**Vendimi nr. 234, datë 11.12.2017**);
8. “Pranimin e pjesëshëm të ankimit administrativ, duke ndryshuar masën e sanksionit gjobë, nr. 72, datë 02.08.2017, nga 2,000,000 lekë në 1,000,000 lekë, të vendosur nga Grupi i Inspektimit ndaj personit fizik Shkëlqim Bylykbashi, autorizuar për subjektin “Tv me kabëll Arbër”. (**Vendimi nr. 235, datë 11.12.2017**);
9. “Pranimin e ankimit administrativ dhe shfuqizimin e sanksionit gjobë, nr. 87, datë 29.08.2017, në masën 2,000,000 lekë, të vendosur nga Grupi i Inspektimit ndaj personit fizik



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Shkëlqim Bylykbashi, autorizuar për subjektin “Tv me kabëll Arbër”. **(Vendimi nr. 236, datë 11.12.2017);**

10. “Refuzimin e ankimit administrativ dhe lënien në fuqi të sanksionit gjobë, nr. 90, datë 30.10.2017, në masën 1,000,000 lekë, të vendosur nga Grupi i Inspektimit ndaj personit fizik Fatjon Latifi, autorizuar për subjektin “Tv me kabëll Ent”. **(Vendimi nr. 237, datë 11.12.2017);**
11. “Miratimin e procedurës së pranimit të nëpunësit civil të kategorisë së lartë drejtuese në Autoritetin e Mediave Audiovizive **(Vendimi nr. 238, datë 11.12.2017).**

Page | 2

Në këtë mbledhje, AMA ra dakord të njoftojë shoqërinë “Capital Radio” sh.p.k., për shlyerjen e detyrimeve financiare ndaj AMA-s dhe Buxhetit të Shtetit dhe të shtyjë shqyrtimin e kërkesës së paraqitur nga ky subjekt për rivendosjen në afat për vendimin e AMA-s, nr. 90, datë 19.05.2016 “Për konstatimin e pavlefshmërisë së licencës së shoqërisë “Capital Radio”, për subjektin radiofonik “Capital Radio”, për mbledhjen e radhës.

Po ashtu, AMA u njoh me masat në zbatim të rekomandimeve të raportit përfundimtar të auditimit “Mbi përputhshmërinë dhe rregullshmërinë financiare” në Autoritetin e Mediave Audiovizive”.

Tiranë, 11 Dhjetor 2017

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE